



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 440/5 prot.

Tiranë, më 09. 10. 2023

### V E N D I M

#### Nr. 194, datë 09. 10. 2023

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën<sup>1</sup> nr. 48 Regj., datë 27.03.2023, nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, përfaqësuar nga A. H., President i Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë, kundër Postës Shqiptare sh.a. dhe Bashkisë Korçë, me pretendim diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar të personave të verbër në Korçë.

### K O N S T A T O I:

#### I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Shoqata në parashtrimet e cituara në ankesë thekson ndër të tjera se, bazuar në Ligjin nr. 8098, datë 28.3.1996 “Për statusin e të Verbërit”, të ndryshuar dhe VKM-në nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, të ndryshuar, personat e verbër trajtohen me pagesë për shkak të verbërisë. Personat e verbër të Bashkisë Korçë, më parë e kanë tërhequr pagesën pranë Bashkisë Korçë. Më pas e kanë marrë pranë bankave të nivelit të dytë. Kjo situatë ka vijuar deri në muajin korrik të vitit 2022. Sipas palës ankuese, bankat nuk i mbanin komision për veprimet e kryera, vetëm 90 lekë për mirëmbajtjen e kartës. Nga muaji korrik i vitit 2022, këto pagesa, personat e verbër të qytetit të Korçës i tërheqin pranë Postës Shqiptare, e cila sipas palës ankuese, i mban për çdo shërbim një komision prej 100 lekë të rinj.

Sipas Shoqatës, personat e verbër që përfitojnë pagesë për shkak të aftësisë së kufizuar kanë të drejtë të zgjedhin vetë se ku mund të tërheqin këtë pagesë, por personave të verbër që jetojnë në territorin e Bashkisë Korçë nuk i është ofruar kjo mundësi. Nga ana e Shoqatës theksohet se: “...në qytetet e tjera si Durrësi, Berati, Erseka, Pogradeci, Tirana etj., ligji zbatohet në mënyrë të drejtë dhe qytetarët e verbër nuk dëmtohen me komisione të cilat nuk duhet të paguhen nga vetë

<sup>1</sup> Plotësuar ankesa nga ana e subjektit ankues përmes e-mail-it më datë 19.04.2023

*ata, dhe si rrjedhojë Posta Shqiptare nuk e mban këtë tarifë për shërbimin që ofron. Nuk e dimë se ku bazohet Posta Shqiptare për Bashkinë Korçë që të mbajë këtë tarifë...për disa persona tarifa mund të jetë diçka normale, por për këtë kategori është shumë, pasi ka burrë e grua plus shoqërues, në disa raste ka që kanë edhe fëmijët, i shkon kjo tarifë 800 lekë në muaj për këtë shkak”.*

Përsa më sipër Shoqata sqaron se: *“Ndihe mi të diskriminuar dhe jemi të pa qartë nëse personat përgjegjës pranë Bashkisë Korçë, Postës Shqiptare, Shërbimit Social Rajonal Korçë i bazojnë këto veprime në ndonjë VKM, apo po kryejnë një diskriminim të pastër ndaj komunitetit të të verbërve që jetojnë në këtë qytet”.*

Shoqata thekson se kanë marrë takim me përfaqësues të Postës Shqiptare të Korçës dhe janë vënë në dijeni se tarifa e mbajtur duhet paguar nga ana e Bashkisë Korçë dhe jo prej tyre. Ndërkohë nga ana e Bashkisë Korçë nuk kanë marrë asnjë zgjidhje lidhur me këtë problem.

Në përfundim, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë ka kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave për heqjen e tarifës së shërbimit nga ana e Bashkisë Korçë.

## **II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri**

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 3, i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “b”, të LMD, ku parashikohet: *“1. Komisioneri ka kompetencë: b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminim ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;”*

Nga aktet e administruara rezulton se, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë është një organizatë jofitimprurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 2749, datë 10.04.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave të verbër që përfitojnë shërbimin në Zyrën e Postës Shqiptare sh.a., Korçë, nga ana Bashkisë Korçë dhe Postës Shqiptare sh.a.

Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, është një organizatë jofitimprurëse e krijuar, me qëllimin mbrojtjen e interesave të të verbërve në Republikën e Shqipërisë.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Shoqëria Posta Shqiptare sh.a., me numër të identifikimit të subjektit (NUIS) J61924007N, është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me aksioner të vetëm Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.<sup>2</sup> Objekti i aktivitetit të Postës Shqiptare sh.a. është: “Shërbime postare, financiare dhe bankare, aktiviteti i gjithë shërbimeve bazë të telekomunikacioneve dhe elektronike, botimi i gazetës “Postieri”, aktivitet radiofonik (“Radio Posta”), veprimtari biznesi, etj, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Agjent në tregun e sigurimeve. Institucion i parasë elektronike.”

Posta Shqiptare sh.a. ofron shërbime publike dhe merr pjesë në sektorin publik. Posta Shqiptare sh.a. edhe pse është në pronësi të shtetit, nuk ushtron funksione, detyra apo kompetenca publike dhe nuk është pjesë e administratës publike. Në kuptim të nenit 7, të LMD, Posta Shqiptare sh.a. është një subjekt privat që ofron shërbime publike dhe jo një autoritet publik.

Bazuar në nenin 32/1/a të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këto shkaqe.

---

<sup>2</sup> Referuar ekstraktit të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB): [www.qkb.gov.al](http://www.qkb.gov.al).

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

**Përsa më lart, referuar neneve sipërcituar të LMD-së, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.**

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr. 440/1 prot., datë 26.04.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, neni 32, pika 2, ka kërkuar nga ana e Bashkisë Korçë dhe Postës Shqiptare sh.a., që të jepen parashtrime lidhur me të gjitha pretendimet e ngritura, nga subjekti ankues.

Në përgjigje të shkresës së sipërcituar, Bashkia Korçë, me shkresën<sup>3</sup> Nr. 3385/1 prot., datë 27.04.2023, informoi ndër të tjera se: *“1. Pagesa pranë bankave të nivelit të dytë, konkretisht First Investment Bank, për personat e verbër është kryer rreth vitit 2009 deri në korrik 2022. Përsa i përket tarifës së mbajtur si komision, nuk kemi informacion pasi është një pagesë në marrëdhënie midis bankës dhe individit që hap numër llogarie.*

*2. Midis Bashkisë Korçë dhe Postës Shqiptare sh.a., Filiali Korçë, në datë 16.08.2022 është nënshkruar një akt marrëveshje me objekt “Kryerja e shërbimit të pagesave të përfitimit të shtesës së invaliditetit, të aftësisë së kufizuar, pagesa për individët me statusin si paraplegjik e tetraplegjik plus paketën higjeno-sanitare, pagesa për individët me statusin e verbërisë, kompensimin e energjisë elektrike, përfitimin e ndihmës ekonomike si dhe shpenzime të tjera të Bashkisë Korçë dhe Njësisë Administrative në juridiksion të kësaj Bashkie”.*

*Në nenin 4 “Të drejtat dhe detyrimet e Postës”, pika 4.1.9 është disponuar se “Posta përfiton të ardhurën prej 100 lekë për pagesat e paaftësisë për invalidin, aftësisë së kufizuar dhe pagesës shtesë për paketë të veçantë higjeno-sanitare për invalidët paraplegjik dhe tetraplegjik dhe 50 lekë për pagesat e përfitimit të ndihmës ekonomike për çdo pagesë të kryer e cila do të arkëtohet nga klienti”.*

*Duke qenë se kjo pikë e marrëveshjes ka të bëjë me të drejtat dhe detyrimet e Postës Shqiptare Filiali Korçë, një shpjegim të plotë detyrohet ta japë ky institucion, se mbi ç’kriter, ligj dhe udhëzim ka vendosur këtë tarifë shërbimi, pasi është një pagesë në marrëdhënie midis postës dhe klientit.*

*Bashkia Korçë, ka përmbushur detyrimet e saj përcaktuar në nenin 5 të akt marrëveshjes ka dërguar në kohë dokumentacionin, list-pagesat për këtë kategori personash duke mosshkaktuar vonesë për pagesën e përfituesve.”*

---

<sup>3</sup> Protokolluar pranë Komisionerit me shkresën Nr. 440/2 prot., datë 08.05.2023

Pavarësisht faktit që Bashkia Korçë në shkresën e mësipërme ka cituar se bashkëngjitur vendos një kopje të akt marrëveshjes së nënshkruar me Postën Shqiptare sh.a., nga ana e saj nuk u përcoll një e tillë.

Në përgjigje të shkresës së Komisionerit, Posta Shqiptare sh.a. nuk vuri në dispozicion të shqyrtimit të çështjes asnjë informacion.

2. Në këto kushte, për administrimin e plotë të informacionit të kërkuar, për një gjykim sa më të drejtë dhe objektiv të çështjes, si dhe në zbatim të parimit të barazisë për një proces të rregullt ligjor, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 440/3 prot., datë 13.06.2023 “*Njoftim për seancë dëgjimore*”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 27.06.2023, duke kërkuar gjithashtu vënien në dispozicion të informacionit si më poshtë:

- Informacion mbi pretendimet e ngritura nga ana e subjektit ankues.
- Informacion sa i përket periudhës që personat e verbër që banojnë në qytetin e Korçës, kanë tërhequr pagesën e verbërisë apo përfitime të tjera, pranë bankave të nivelit të dytë, cili është subjekti që ka paguar tarifën e shërbimit? Cila është procedura e ndjekur nga ana e Bashkisë Korçë për periudhën e pretenduar nga pala ankuese, përpara muajit korrik 2022?
- Kopje të akt marrëveshjes së lidhur ndërmjet Bashkisë Korçë dhe Postës Shqiptare sh.a.
- Informacion nëse nga ana e Postës Shqiptare sh.a., ofrohet ky shërbim me apo pa pagesë në qytete të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë. A janë nënshkruar kontrata të ngjashme nga Posta Shqiptare sh.a., me njësi të tjera të qeverisjes vendore për ofrimin e këtij shërbimi për personat me aftësi të kufizuara të verbër? Nëse po, të vihen në dispozicion disa kontrata në të cilat shërbimi i ofrohet me apo pa pagesë.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 27.06.2023, në mungesë të Bashkisë Korçë, e cila megjithëse kishte dijeni për datën dhe orën e zhvillimit të kësaj seance nuk dërgoi asnjë përfaqësues. Në seancë dëgjimore u paraqit përfaqësuesi i palës ankuese z. Gj. S<sup>4</sup>. dhe përfaqësuesi i Postës Shqiptare sh.a., z. G. Xh<sup>5</sup>.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Në deklaratimet e bëra gjatë seancës, subjekti ankues mbajti të njëjtin qëndrim, si ai i komunikuar shkresërisht Komisionerit dhe shtoi ndër të tjera se: “*Diskriminimi fillon nga Bashkia Korçë, për faktin se personat e verbër kanë të drejtë të zgjedhin se ku duan të tërheqin pagesat, në bankat e nivelit të dytë apo në zyrat e Postës Shqiptare. Nga ana e Bashkisë Korçë nuk është marrë miratimi i personave të verbër për këtë. Referuar legjislacionit, pagesat e verbërisë nuk duhet të*

<sup>4</sup> Me Autorizim nr. 28 prot., datë 27.06.2023, lëshuar nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë.

<sup>5</sup> Me Autorizim Përfaqësimi nr. 1309 prot., datë 27.06.2023, lëshuar nga Posta Shqiptare sh.a.

*preken nga asnjë lloj komisioni që vjen si pasojë e marrjes së shërbimit pranë bankave apo pranë Postës. Kjo marrëdhënie duhet të jetë e rregulluar ndërmjet Bashkisë Korçë dhe Postës Shqiptare dhe jo ndërmjet përfituesit dhe Postës, pasi këto pagesa nuk konsiderohen të ardhura por janë pagesa që merren nga personat e verbër, për eliminimin e barrierave që verbëria u ka shkaktuar. Në pjesën më të madhe të qyteteve personat e verbër nuk komisionohen në marrjen e pagesave të verbërisë. Ndërsa, në Bashkinë Korçë, i mbahet komision në pagesa të gjithë kategorisë së personave me aftësi të kufizuara.”*

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i Postës Shqiptare sqaroi ndër të tjera se: “Posta Shqiptare ofron shërbimin e pagesave për personat me aftësi të kufizuara në disa bashki të vendit, referuar kontratave të nënshkruara. Shërbimi që ne ofrojmë, ka një tarifë e cila mund të mbulohet nga ana e bashkive, në rastin konkret të Bashkisë Korçë. Filiali i Postës Shqiptare Korçë, ka nënshkruar një kontratë me Bashkinë Korçë në vitin 2020 dhe e fundit është nënshkruar në vitin 2022. Referuar VKM-së nr. 597/2019, pika 3, parashikon se: “Pagesat e ndihmës ekonomike, paguhen nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë bashkive/njësive administrative ku ka vendbanimin përfituesi. Bashkia merr masa që këto pagesa të merren të plota nga përfituesit dhe të mos tarifohen/komisionohen”. Në këtë kuptim, Bashkia Korçë është ajo e cila duhet të mbulojë komisionet apo tarifën e shërbimit të Postës Shqiptare. Bashkia Tiranë, referuar kontratës së nënshkruar me Postën Shqiptare, i mbulon të gjitha tarifën vetë dhe nga ana e Postës personat me aftësi të kufizuara e marrin shërbimin pa pagesë. Ka edhe bashki të tjera, si për shembull: Bashkia Patos e cila ka një tarifë fikse për të gjitha shërbimet që personat me aftësi të kufizuara marrin pranë Postës. Duke qenë se ne jemi një shoqëri që ofron shërbime publike, e cila ushtron aktivitetin e saj mbështetur në shërbimet e ofruara kundrejtë pagesës. Nëse shërbimet do të ofroheshin pa pagesë, atëherë shoqëria do të shkonte drejtë falimentimit.”.

Në përfundim të seancës, Posta Shqiptare vuri në dispozicion të Komisionerit disa kontrata të lidhura ndërmjet saj dhe njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë. Ndërsa nga ana e subjektit ankues u depozituan në cilësinë e provës, (për të cilat u njohën edhe palët gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore), kopje të disa mandat pagesave të personave të verbër të qytetit të Korçës, të cilët kanë tërhequr pagesat e aftësisë së kufizuar pranë Filialit të Postës Shqiptare Korçë.

### **III. Vlerësimi i fakteve nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.**

#### **A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.**

Mbështetur në informacionin e administruar, Bashkia Korçë për periudhën nga viti 2009, deri në vitin 2020, ka patur një kontratë/akt marrëveshje me një prej bankave të nivelit të dytë, konkretisht First Investment Bank, përmes së cilës personat e verbër, por dhe kategoritë e tjera të aftësisë së kufizuar, kanë tërhequr pagesat e përfitimit të aftësisë së kufizuar apo edhe të ndihmës ekonomike pranë saj.



Më datë 30.03.2020, Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës Shqiptare Korçë, kanë nënshkruar një Akt-marrëveshje<sup>6</sup>, me objekt: *“Kryerjen e shërbimit të pagesave të përfitimit të paaftësisë, të aftësisë së kufizuar dhe pagesa shtesë për paketë të veçantë higjeno-sanitare për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë dhe shpenzime të tjera nga Filiali i Postës sh.a. Korçë”*.

Në Kreun II, pika 1/9 të akt-marrëveshjes, parashikohet se: *“Posta përfiton të ardhurën prej 100 lekë për çdo pagesë të kryer e cila do të arkëtohet nga klienti”*. Në zbatim të këtij parashikimi të cituar në aktmarrëveshje, personat me aftësi të kufizuara, si dhe personat e verbër, për çdo veprim apo shërbim që do të merrnin nga ana e Filialit të Postës Korçë, lidhur me përfitimin e pagesave të aftësisë së kufizuar, pagesave shtesë për paketë të veçantë higjeno-sanitare për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë, ndihmën ekonomike dhe shpenzime të tjera, do të ishin të detyruar të paguanin 100 lekë.

Pas përfundimit të afatit 1-vjeçar të akt-marrëveshjes së sipërcituar, Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës Shqiptare Korçë, kanë nënshkruar një Akt-marrëveshje<sup>7</sup> të re më datë 16.08.2022. Referuar nenit 2, objekti i kësaj aktmarrëveshje është: *“Kryerja e shërbimit të pagesave të përfitimit të shtesës së invaliditetit, të aftësisë së kufizuar, pagesa për invalidët me statusin si paraplegjik e tetraplegjik plus paketën higjeno-sanitare, pagesa për individët me statusin e verbërisë, kompensimin e energjisë elektrike, përfitimit të ndihmës ekonomike, si dhe shpenzime të tjera të Bashkisë Korçë dhe të njëjve administrative në juridiksionin e kësaj Bashkie, nga Filiali i Postës sh.a. Korçë”*.

Në nenin 4.1.9 të akt-marrëveshjes së re, parashikohet se: *“Posta përfiton të ardhurën prej 100 lekë për pagesat e paaftësisë për invalidin, aftësisë së kufizuar dhe pagesës shtesë për paketë të veçantë higjeno-sanitare për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, dhe 50 lekë për pagesat e përfitimit të ndihmës ekonomike për çdo pagesë të kryer e cila do të arkëtohet nga klienti”*. Në zbatim të këtij parashikimi të cituar, personat me aftësi të kufizuara, si dhe personat e verbër, për pagesat e invaliditetit, aftësisë së kufizuar dhe pagesës shtesë për paketë të veçantë higjeno-sanitare, do të jenë të detyruar të paguanin 100 lekë. Ndërsa për pagesat e përfitimit të ndihmës ekonomike, personat përfitues që mund të bëjnë pjesë ose jo në kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, do të jenë të detyruar të paguajnë 50 lekë.

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga palët në proces, referuar ankesës, personat me aftësi të kufizuar, të verbër, që mund të marrin njëkohësisht pagesat e invaliditetit, aftësisë së kufizuar, pagesat shtesë për paketë të veçantë higjeno-sanitare dhe pagesën e ndihmës ekonomike, në zbatim të aktmarrëveshjes së sipërcituar, do të jenë të detyruar të paguajnë për secilin shërbim komision apo tarifën e parashikuar. Pra, janë të detyruar të paguajnë në varësi të numrit të pagesave që kanë për të tërhequr nga ana e Filialit i Postës sh.a. Korçë.

<sup>6</sup> Nr. 2504 prot., datë 30.03.2020, i Bashkisë Korçë dhe nr. 217 prot., datë 30.03.2020 i Filialit të Postës sh.a. Korçë.

<sup>7</sup> Nr. 7015 prot., datë 16.08.2022, i Bashkisë Korçë dhe nr. 449 prot., datë 16.08.2022 i Filialit të Postës sh.a. Korçë.

Sakaq, referuar provave të përcjella nga ana e subjektit ankues, konstatohet që personat e verbër të Bashkisë Korçë, në momentin që kanë tërhequr pagesën e invaliditetit apo të aftësisë së kufizuar, i është mbajtur komision prej 100 lekë për secilin shërbim, si më poshtë:

- Shtetasit H. C., mbështetur në mandat pagesën e lëshuar nga Filiali i Postës sh.a. Korçë, me nr. ref. 53244342, i është mbajtur komision 100 lekë për tërheqjen e pagesës për të verbër;
- Shtetases M. C., mbështetur në mandat pagesën e lëshuar nga Filiali i Postës sh.a. Korçë, me nr. ref. 53244374, i është mbajtur komision 100 lekë për tërheqjen e pagesës për të verbër;
- Shtetases E. L., mbështetur në mandat pagesat e lëshuara nga Filiali i Postës sh.a. Korçë, me nr. ref. 53296893, i është mbajtur komision 100 lekë, për tërheqjen e pagesës së paaftësisë dhe referuar mandat pagesës me nr. ref. 53296945, i është mbajtur sërish komision për tërheqjen e pagesës për të verbër;
- Shtetasit J. L., mbështetur në mandat pagesën e lëshuar nga Filiali i Postës sh.a. Korçë, me nr. ref. 53297092, i është mbajtur komision 100 lekë për tërheqjen e pagesës për invalid të plotë;
- Shtetases L. L., mbështetur në mandat pagesën e lëshuar nga Filiali i Postës sh.a. Korçë, me nr. ref. 53297028, i është mbajtur komision 100 lekë për tërheqjen e pagesës për të verbër;
- Shtetasit L. B., mbështetur në mandat pagesën e lëshuar nga Filiali i Postës sh.a. Korçë, me nr. ref. 53236003, i është mbajtur komision 100 lekë për tërheqjen e pagesës për të verbër;
- Shtetases B. D., mbështetur në mandat pagesat e lëshuara nga Filiali i Postës sh.a. Korçë, me nr. ref. 53232710, i është mbajtur komision 100 lekë, për tërheqjen e pagesës për të verbër dhe referuar mandat pagesës me nr. ref. 53232741, i është mbajtur sërish komision për tërheqjen e pagesës për invalid të plotë;
- Shtetasit A. K., mbështetur në mandat pagesën e lëshuar nga Filiali i Postës sh.a. Korçë, me nr. ref. 53210886, i është mbajtur komision 100 lekë për tërheqjen e pagesës për të verbër;
- Shtetasit N. K., mbështetur në mandat pagesën e lëshuar nga Filiali i Postës sh.a. Korçë, me nr. ref. 53210906, i është mbajtur komision 100 lekë për tërheqjen e pagesës për të verbër;
- Shtetases R. K., mbështetur në mandat pagesën e lëshuar nga Filiali i Postës sh.a. Korçë, me nr. ref. 53213674, i është mbajtur komision 100 lekë për tërheqjen e pagesës për të verbër;
- Shtetasit A. K., mbështetur në mandat pagesën e lëshuar nga Filiali i Postës sh.a. Korçë, me nr. ref. 53213647, i është mbajtur komision 100 lekë për tërheqjen e pagesës për të verbër;

Në analizë përse më sipër, konstatohet që të njëjtin person i cili ka marrë pagesën e të verbërit apo edhe të aftësisë së kufizuar, i është mbajtur për secilin shërbim nga 100 lekë komision. Gjithashtu, konstatohet se tre anëtarët e një familje (E. L., J. L. dhe L. L.) që kanë tërhequr pagesat e tyre, kanë paguar komision prej rreth 400 lekë.

Mbështetur në informacionin e administruar, personat e verbër në Bashkinë e Korçës, të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike, pagesë të aftësisë së kufizuar, apo edhe pagesa të tjera si pasojë e saj, janë vënë përpara detyrimit që t'i tërheqin pranë Filialit të Postës sh.a. Korçë dhe sa herë të tërheqin këto pagesa, të tarifohen me një komision prej 100 apo 50 lekë, për çdo shërbim në varësi të shërbimeve të marra.



Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmësit personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, në Kreun IV, pika 7, ka parashikuar se: “Pagesat për personat me aftësi të kufizuara kryhen nëpërmjet shërbimeve bankare ose Postës Shqiptare, sipas alternativës së përzgjedhur nga vetë individi”.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 4.9.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, në Kreun II, pika 13, ka parashikuar se: “Pagesat e ndihmës ekonomike, në masën e përcaktuar në kreun III, të këtij vendimi, paguhen nga shërbimet bankare ose Posta Shqiptare, pranë bashkive/njërive administrative ku ka vendbanimin përfituesi. Bashkia merr masa që këto pagesa të merren të plota nga përfituesit dhe mos të tarifohen/komisionohen”.

Udhëzimi Nr. 47, datë 11.01.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar”, i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në pikën 5 të tij ka përcaktuar se: “Pagesat e përfituara për shkak të verbërisë, të përcaktuara në vendimin nr. 277, datë 18.06.1997 të Këshillit të Ministrave dhe të gjitha përfitimet e tjera apo kompensimet që i verbëri përfiton sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, merren të plota nga përfituesit. Bashkia merr masa që këto pagesa të mos tarifohen/komisionohen”.

Në analizë të përcaktimeve të akteve të sipërcituara, vlerësohet se:

- personat me aftësi të kufizuara, të verbërit, si dhe ata që përfitojnë ndihmë ekonomike, duhet t'i marrin këto pagesa të plota dhe pa paguar tarifa apo komision shërbimi;
- përfituesit e aftësisë së kufizuar, ku përfshihen dhe të verbërit, përzgjedhin vetë alternativën se ku duan t'i tërheqin pagesat, nëpërmjet shërbimeve bankare ose Postës Shqiptare;
- Bashkitë kanë detyrimin që të marrin masa që këto pagesa të merren të plota nga përfituesit dhe mos të tarifohen/komisionohen;

Nga informacioni i administruar, Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, pavarësisht detyrimeve të përcaktuara në aktet e sipërcituara, kanë nënshkruar akt-marrëveshje në shkelje të tyre, duke i vendosur tarifa/komisione për shërbimet që marrin si pasojë e aftësisë së kufizuar dhe duke mos i marrë të plota përfitimet apo kompensimet që personat me aftësi të kufizuara apo të verbërit përfitojnë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, nga ana e Bashkisë Korçë, pa marrë më parë miratimin e përfituesve, në rastin konkret të verbërve të Korçës, ka përzgjedhur institucionin ku ata duhet të marrin shërbimin pa dakordësinë e tyre, në shkelje të përcaktimeve ligjore në fuqi.

Gjatë shqyrtimit të ankesës në fjalë, Posta Shqiptare sh.a., ka vënë në dispozicion të Komisionerit ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore, kopje të disa aktmarrëveshjeve të lidhura nga filialet e saj në Shqipëri, me bashki të ndryshme. Nga analiza e tyre rezulton se:

- Referuar nenit 4, pika 4.1.4, të Akt-marrëveshjes së lidhur ndërmjet Filialit të Postës sh.a. Tiranë dhe Bashkisë Tiranë, ku cilësohen detyrimet e Bashkisë, parashikohet se: *“Çdo muaj kryen pagesën e komisionit të shërbimit që është 50 lekë për çdo përfitues të paguar, sipas faturës tatimore të depozituar nga Posta për çdo muaj që bëhet kalimi i fondit për të gjitha kategoritë e përfituesve në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë”*;
- Referuar pikës 5, të kreut III, të Akt-marrëveshjes<sup>8</sup> së lidhur ndërmjet Filialit të Postës sh.a. Fier dhe Bashkisë Roskovec, parashikohet se: *“Kjo akt-marrëveshje lidhet nëpërmjet Bashkisë për kryerjen e shërbimit të pagesave të përfitimit të paaftësisë për invalidin, të aftësisë së kufizuar, përfitimin të ndihmës ekonomike dhe pagesa shtesë për paketën higjieno-sanitare për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë. Pagesa për kryerjen e këtij shërbimi nga Posta Shqiptare do të jetë 0.6 % e vlerës së përgjithshme të kategorive përfituese të sipërcituara dhe do të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Roskovec për vitin 2023”*;
- Referuar pikës 5, të kreut III, të Akt-marrëveshjes<sup>9</sup> së lidhur ndërmjet Filialit të Postës sh.a. Fier dhe Bashkisë Mallakastër, parashikohet se: *“Kjo akt-marrëveshje lidhet nëpërmjet Bashkisë për kryerjen e shërbimit të pagesave të përfitimit të paaftësisë për invalidin, të aftësisë së kufizuar, përfitimin të ndihmës ekonomike dhe pagesa shtesë për paketën veçantë higjieno-sanitare për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë. Pagesa për kryerjen e këtij shërbimi nga Posta Shqiptare do të jetë 0.6 % e vlerës së përgjithshme të kategorive përfituese të sipërcituara dhe do të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Mallakastër për vitin 2023”*;
- Referuar pikës 5, të kreut III, të Akt-marrëveshjes<sup>10</sup> së lidhur ndërmjet Filialit të Postës sh.a. Fier dhe Bashkisë Mallakastër, parashikohet se: *“Kjo akt-marrëveshje lidhet nëpërmjet Bashkisë për kryerjen e shërbimit të pagesave të përfitimit të paaftësisë për invalidin, të aftësisë së kufizuar, përfitimin të ndihmës ekonomike dhe pagesa shtesë për paketën veçantë higjieno-sanitare për invalidët paraplegjikë e tetraplegjikë. Pagesa për kryerjen e këtij shërbimi nga Posta Shqiptare do të jetë 0.6 % e vlerës së përgjithshme të kategorive përfituese të sipërcituara dhe do të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë Fier për vitin 2023”*;
- Referuar pikës 2/1, të kreut ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e palëve, të Akt-marrëveshjes<sup>11</sup> së lidhur ndërmjet Filialit të Postës sh.a. Fier dhe Bashkisë Patos, theksohet se: *“Tarifa për këtë shërbim që kalon në favor të Postës është 50 lekë për të gjitha kategoritë”*;
- Referuar nenit 4, të Akt-marrëveshjes<sup>12</sup> së lidhur ndërmjet Filialit të Postës sh.a. Gjirokastrë dhe Bashkisë Përmet, parashikohet se: *“...4.2.2 Ofruesi i Shërbimit do të aplikojë një komision prej 50 (pesëdhjetë) lekë për çdo person që përfiton nga skemat e Bashkisë, PAK,*

<sup>8</sup> Nr. 3249 prot., datë 17.05.2023, i Bashkisë Roskovec dhe nr. 204 prot., datë 11.05.2023 i Filialit të Postës sh.a. Fier.

<sup>9</sup> Nr. 17/1 prot., datë 04.01.2023, i Bashkisë Mallakastër dhe nr. 539 prot., datë 30.12.2022 i Filialit të Postës sh.a. Fier.

<sup>10</sup> Nr. 11404 prot., datë 30.12.2022, i Bashkisë Fier dhe nr. 543 prot., datë 30.12.2022 i Filialit të Postës sh.a. Fier.

<sup>11</sup> Nr. 2822/1 prot., datë 05.12.2022, i Bashkisë Patos dhe nr. 506 prot., datë 01.12.2022 i Filialit të Postës sh.a. Fier.

<sup>12</sup> Nr. 225 prot., datë 26.01.2022, i Bashkisë Përmet dhe nr. 30 prot., datë 27.01.2022 i Filialit të Postës sh.a. Gjirokastrë.

*pagesën e invalidit, të verbërit, bonus qeraje, shpërblime lindjesh, pagesa të kryepleqve si dhe pagesa të sporteve. Komisioni i shërbimit do i mbahet çdo përfituesi (klientit). 4.2.3 Ofruesi i Shërbimit për pagesat e ndihmës ekonomike do të aplikojë një komision prej 1 % (një përqind) me TVSH të cilën do e paguaj “Përfituesi i Shërbimit” të vlerës totale të lëvruar nga skemat e Bashkisë Përmet për ndihmën ekonomike, ndihmë ekonomike 6% dhe pagesat për familjet në nevojë. Likujdimi i faturës tatimore shitje të lëshuar nga ofruesi i shërbimit do të bëhet nëpërmjet llogarisë bankare në Raiffeisen Bank.”;*

- Referuar kreut III, të Akt-marrëveshjes<sup>13</sup> së lidhur ndërmjet Filialit të Postës sh.a. Lezhë dhe Bashkisë Lezhë, parashikohet se: *“Për kryerjen e shërbimit të pagesave sipas fondeve të akorduara nga Bashkia Lezhë, Posta Shqiptare përfiton tarifën 0.5 % të totalit të volumit të pagesave të kryera gjatë muajit”;*

Në analizë sa më lart, konstatohet se Filialet e Postës Shqiptare sh.a. me bashki të ndryshme kanë nënshkruar akt-marrëveshje të ndryshme. Nga akt-marrëveshjet e administruara, konstatohet që vetëm Bashkia Patos, i mban tarifë shërbimi/komision prej 50 lekë të gjitha kategorive përfituese.

Në përfundim nga provat e administruara, rezulton që pavarësisht parashikimeve ligjore në fuqi:

- Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, kanë nënshkruar akt-marrëveshje në shkëlqje të parashikimeve ligjore të sipërcituara;
- Bashkia Korçë, pa marrë më parë miratimin e përfituesve, në rastin konkret të verbërve të Korçës, ka përzgjedhur institucionin ku ata duhet të marrin shërbimin pa dakordësinë e tyre.

**Nga analizimi i situatës, si dhe referuar ngjarjeve e fakteve, objekt hetimi, rezulton qartazi se, Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, pavarësisht përcaktimeve ligjore në fuqi ka trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, të verbër, të Bashkisë Korçë dhe njërive administrative në varësi të saj, në raport me të drejtën e tyre ligjore, për marrjen e shërbimeve<sup>14</sup> pa pagesë në zyrën e Filialit të Postës sh.a. Korçë dhe përzgjedhur institucionin ku ata duhet të marrin shërbimin.**

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Mbështetur në nenin 2<sup>15</sup>, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ky ligj, ndalon situatat kur persona ose grupe personash në një

<sup>13</sup> Nr. 13624 prot., datë 21.11.2019, i Bashkisë Lezhë dhe nr. 929 prot., datë 21.11.2019 i Filialit të Postës sh.a. Lezhë.

<sup>14</sup> Pagesë paaftësie, pagesë verbërie, ndihmë ekonomike etj.

<sup>15</sup> *“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje që nxit diskriminim.”*

situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: *“Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive”*.

Subjekti ankues, Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, ka pretenduar diskriminim për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, të personave të verbër në Bashkinë Korçë. Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, por pretendon diskriminimin e personave të verbër që përfitojnë shërbimin në Zyrën e Postës Shqiptare sh.a., Korçë, nga ana Bashkisë Korçë dhe Postës Shqiptare sh.a.

Konventa e OKB-së *“Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara<sup>16</sup>”*, në nenin 1 të saj, ka përcaktuar se: *“Personat me aftësi të kufizuara përfshijnë ata që kanë dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore afatgjata, të cilat, në ndërveprim me barriera të ndryshme, mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në baza të barabarta me të tjerët”*.

Ligji nr. 8098, datë 28.3.1996 *“Për Statusin e të Verbërit”*, i ndryshuar, si dhe një sërë aktesh të tjera ligjore e nënligjore kanë legjitimuar posedimin e statusit të personit të verbër si aftësi të kufizuar.

Referuar nenit 1, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ky shkak i pretenduar nga subjekti ankues, në emër të personave të verbër të Bashkisë Korçë, konsiderohet si shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD, si dhe subjekti ankues ka depozituar prova të cilat faktojnë se personat e verbër të Bashkisë Korçë e mbartin atë. Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ligji ka bërë në nenin 3, të ligjit *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të

<sup>16</sup> Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 108/2012.

favorshme dhe të padrejta që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura. Në mungesë të një shkakut të mbrojtur jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim i pafavorshëm konsiderohet diskriminim sipas ligjit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të aftësisë së kufizuar.

### **C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.**

Komisioneri ka shqyrtuar dhe analizuar faktin, nëse personat e verbër të Bashkisë Korçë, janë trajtuar në mënyrë të padrejtë apo të pafavorshme nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, në raport me parashikimet ligjore të posaçme, lidhur me të drejtën për të përfituar shërbimet postare pa pagesë, që lidhen me përfitimin e pagesave të aftësisë së kufizuar, ndihmës ekonomike etj.

Çështjet e diskriminimit kërkojnë që të vërtetohet nëse ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive për trajtimin ndryshe të evidentuar.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Kushtetuta si akti themeltar i Republikës së Shqipërisë, sanksionon se: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme, të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”*. Neni 18, i saj shpreh se: *“Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit”*.

Në nenin 59, shkronjat e) dhe f) të saj ka parshikuar se:

*“Shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon:*

*e) përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët;*

*f) riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, si dhe përmirësimin në vazhdimësi të kushteve të tyre të jetesës”.*

Gjykata Kushtetuese, në jurisprudencën e saj, ka mbajtur qëndrimin se, parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në respektim të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal të tyre, ashtu edhe atë material.

Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që buron nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor<sup>17</sup>.

Me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, e drejta ndërkombëtare që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare (*e njohur ndryshe edhe si “e drejta konventore”*) ka një vend të posaçëm.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Po ashtu, kjo dispozitë kushtetuese duhet lexuar në harmoni edhe me nenin 122, pikat 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku sanksionohet se:

*“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji...*

*2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të...*

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij. Konventa njeh dhe parashikon kufizime të përgjithshme dhe kufizime specifike për të drejta të veçanta.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), në nenin 14 të saj, ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara në të, bazuar në një listë joshteruese shkaqesh. Ndërkohë Protokollin 12-të i Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me *“gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji”* dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja.

Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur subjekti është diskriminuar:

*“a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë:*

---

<sup>17</sup> Citojmë këtu, Vendimet e Gjykatës Kushtetuese me: nr. 2, datë 03.02.2010, nr.1, datë 12.01.2011, nr. 23, datë 08.06.2011.



*b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm;*

*c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare;*

*d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.*

Shqipëria e ratifikoi Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të, që prej 11 Shkurtit 2013.

Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPAK)<sup>18</sup>, ka për qëllim të nxisë, mbrojtje dhe të sigurohet që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre.

Në kuptimin të kësaj Konvente: *“Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar”* ka kuptimin e çdo dallimi, përjashtimi apo kufizimi për shkak të aftësisë së kufizuar, që ka si qëllim ose ndikon në pengimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit, njësoj si gjithë të tjerët, të të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në fushën politike, ekonomike, shoqërore, kulturore, civile apo në ndonjë fushë tjetër. Në këtë përkufizim përfshihen të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë edhe mohimin e përshtatjes brenda logjikës.

Parimet e kësaj Konvente përfshijnë:

- a) Respektin për dinjitetin, autonominë individuale përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit;
- b) Mosdiskriminimin;
- c) Pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri;
- d) Respektin për ndryshimin dhe pranimin e personave me aftësi të kufizuar si pjesë e diversitetit njerëzor dhe humanizmit;
- e) Mundësi të barabarta;
- f) Akses;
- g) Barazi ndërmjet burrave dhe grave;
- h) Respekt për kapacitetet në zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuar, si edhe respektimi i të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuar për të ruajtur identitetin e tyre.

Neni 5 i Konventës, ka përcaktuar se:

*“1. Shtetet Palë pranojnë se të gjithë personat janë të barabartë përpara ligjit dhe se gëzojnë të drejtë pa asnjë diskriminim për mbrojtje të barabartë dhe përfitim të barabartë nga ligji.*

*2. Shtetet Palë duhet të ndalojnë çdo lloj diskriminimii për shkak të aftësisë së kufizuar dhe t’u garantojnë personave me aftësi të kufizuar mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive ndaj çdo lloj diskriminimi dhe në cdo rrethanë.*

<sup>18</sup> Shqipëria e ratifikoi KDPAK në Dhjetor të vitit 2012 dhe është bërë Palë në të që prej 11 Shkurtit 2013.

3. Me qëllim nxitjen e barazisë dhe eliminimit të diskriminimit, Shtetet Palë duhet të ndërmarrin të gjitha hapat e duhura për tu siguruar se është ofruar akomodim i arësyeshëm.

4. Masat specifike të cilat janë të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë e personave me aftësi të kufizuara nuk do të konsiderohen diskriminim sipas termave të kësaj Konvente”.

Për një kohë të gjatë, personat me aftësi të kufizuara janë parë më shumë si objekte se sa si subjekte të së drejtës, duke evidentuar dhe theksuar paaftësinë/të. Ndërkohë, qasja e re që ofron Konventa “Për të drejtat e personave e aftësi të kufizuara” bazohet jo më në modelin e “bamirësisë”, por në atë të të drejtave të njeriut, ku personat me aftësi të kufizuara, si të gjithë qeniet njerëzore, i zotërojnë të drejtat e tyre në mënyrë të pakushtëzuar.

Në qendër të vëmendjes nuk është paaftësia e mundshme, por barrierat që vendos shteti apo shoqëria, duke penguar gëzimin e tyre. Barrierat janë të shumëllojshme, ku përveç barrierave fizike, barrierat e ndryshme shoqërore të bazuara në stereotipe, çojnë drejt përjashtimit të personave me aftësi të kufizuara dhe potencialisht mbështesin këtë përjashtim.

Konkretisht, Konventa "Për të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara", në nenin 4 ku parashikon “Detyrimet të përgjithshme”, sanksionon shprehimisht se: “Në zhvillimin dhe zbatimin e legjislacionit për zbatimin e kësaj Konvente, si dhe për proceset e tjera vendim-marrëse në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me personat me aftësi të kufizuara. Shtetet Palë duhet të konsultohen në mënyrë aktive me personat me aftësi të kufizuara, përfshirë këtu edhe fëmijët me aftësi të kufizuara për të siguruar përfshirjen e tyre nëpërmjet organizatave të tyre përfaqësuese”.

Ligji nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, parashikon gjithë-përfshirjen dhe një rol aktiv të organizatave në mbrojtjen e interesave të personave me aftësi të kufizuara.

Kështu, ndër parimet bazë të këtij ligji, sipas nenit 4 të tij, është pjesëmarrja e personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet konsultimit individual dhe përfshirjes aktive të personave me aftësi të kufizuara dhe organizatave të tyre përfaqësuese, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara. Organizatë për personat me aftësi të kufizuara, sipas nenit 3 pika 8, përkufizohet si çdo organizatë jofitimprurëse, që ofron shërbime për personat me aftësi të kufizuara dhe/ose kryen aktivitetet në mbrojtje të interesave të këtyre personave e të familjeve të tyre.

Ligji nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara”, i ndryshuar, ka për qëllim:

“a) të garantojë nxitjen dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara për të mundësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në të gjitha sferat e shoqërisë, në kushte të barabarta me të tjerët, duke mundësuar autonominë dhe jetesën e pavarur për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, nëpërmjet ofrimit të ndihmës e të mbështetjes;

b) të përcaktojë përgjegjësinë e të gjitha strukturave publike dhe jopublike, përfshirë organet shtetërore, qendrore dhe vendore, në zbatimin e parimeve të përfshirjes dhe aksesueshmërisë për të zvogëluar, deri në heqje, pengesat për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim mundësimin e pjesëmarrjes së tyre të barabartë në shoqëri”.

Në këtë ligj:

“Aksesueshmëri” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve;

- “Pengesat” nënkupton: ...ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika.

Parimet bazë të këtij ligji janë:

- a) mosdiskriminimi, me anë të të cilit garantohet se personat me aftësi të kufizuara të mos trajtohen në mënyrë të diferencuar, nisur nga dëmtimi që kanë;

.....

- ç) garantimi i aksesueshmërisë nëpërmjet mënjimit të pengesave të të gjitha llojeve;

Sa më lart, ku termi “aksesueshmëri” përcakton mënjanimin e pengesave të të gjitha llojeve, përfshirë edhe pengesat institucionale, ato në legjislacion dhe në politikat e ndryshme hartuar në ndihmesë të personave me AK.

VKM-ja nr. 722, datë 11.11.2019, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre”, VKM-ja nr. 597, datë 4.9.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” dhe Udhëzimi i Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 47, datë 11.01.2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin nr. 2365, datë 26.11.2008 “Mbi zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 277, datë 18.06.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”, i ndryshuar”, parashikojnë në mënyrë të qartë dhe të shprehur të drejtën e personave me aftësi të kufizuara, të verbër, subjekt ankues pranë KMD-së, për të përzgjedhur ku ata duhet të marrin shërbimin, në atë postar apo bankar dhe përfitimin e tij<sup>19</sup> pa pagesë, detyrime të cilat duhet të mbulohen nga bashkitë.

Për rrjedhojë, bazuar sa më sipër, si dhe në shqyrtim të pretendimit të Shoqatës, Komisioneri konstaton se, nga ana e Bashkisë hapatazi janë shkelur dispozitat e mësipërme ligjore.

Sipas nenit 3, pika 1 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, diskriminimi përkufizohet si: “çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

<sup>19</sup> Pagesë paaftësie, pagesë verbërie, ndihmë ekonomike etj.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një *situatë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.*

Neni 20/1 i LMD-së, përcakton qartë detyrimin e personave fizik ose juridik që ofrojnë të mira apo shërbime për publikun, duke cituar shprehimisht:

*“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi.*

Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për: “...c) kontributin dhe mundësinë për të përfituar të mira nga skemat e mbrojtjes shoqërore, duke përfshirë asistencë sociale, sigurime shoqërore, mbrojtje të fëmijëve, përfitim për shkak të aftësisë së kufizuar, apo ndonjë skemë tjetër të mbrojtjes sociale ose avantazh tjetër social të ofruar për publikun”.

Bazuar në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: “Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Në të njëjtën frymë është dhe ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, i cili, në nenin 33, pikën 7/1 të tij, ka përcaktuar se: “Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se *prima facie* është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, “subjekti ankues” duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjektet kundër të cilëve është drejtuar ankesa, të cilët duhet të tregojnë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojnë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>20</sup>

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga subjekti ankues, *së pari*, Komisioneri ka vlerësuar dhe ka arritur në përfundimin se kategoria e personave me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën për të marrë shërbimin nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë.

*Së dyti*, Komisioneri, do të vlerësojë nëse ky trajtim i padrejtë, i pafavorshëm i kategorisë së personave me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, lidhet me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në faktet dhe provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe analizimit të legjislacionit përkatës<sup>21</sup>, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, personat me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, në raport me lehtësirat e parashikuara drejtpërdrejtë në legjislacionin e sa më sipër analizuar.

Personat me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, kanë pretenduar se janë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, përmes ofrimit me pagesë dhe të detyruar pranë zyrave të Filialit të Postës sh.a. Korçë, megjithëse ligji, subjekt i të cilit janë, ua njeh këtë të drejtë pa pagesë, dhe po ashtu përcakton dhe detyrimin ligjor të shtetit, Bashkisë në këtë rast, për të lënë në të drejtën e personave me aftësi të kufizuara, përzgjedhjen e institucionit (shërbimin postar apo bankar) ku ata do të marrin shërbimin pa pagesë.

Fakti i posedimit së shkakut të mbrojtur nga ana e personave me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, rezulton i njohur dhe i pranuar nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, pasi pikërisht bazuar në këtë shkak, ata përfitojnë nga pagesat e aftësisë së kufizuar dhe verbërisë në Bashkinë e Korçës.

Komisioneri vlerëson se, shteti duhet t'u sigurojë mbrojtje efektive dhe barazi në trajtim të gjithë personave me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëlloj si të

<sup>20</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

<sup>21</sup> Shih Ndarjen III, nëndarja A.1, të këtij vendimi.

tjerët, si dhe mundësisht t'u garantohet jetesa e pavarur. Përfitimi i pagesave të aftësisë së kufizuar dhe paketave në mbështetje të saj, janë vendosur nga shteti për t'i siguruar kësaj kategorie mundësinë e një jetese të pavaruar në mënyrë që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët.

Në kushtet kur shteti, krijon lehtësira të caktuara përmes parashikimeve specifike në akte ligjore apo nënligjore të tij, për kategoritë përfituese të personave me aftësi të kufizuara, të verbër, duhet të sigurohet që t'i ofrojë këto shërbime pa asnjë lloj diskriminimi, të çfarëdolloj forme.

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025<sup>22</sup>, citon ndër të tjera se:

*“Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar (PKVPAK) 2021-2025, është një dokument ndërsektorial i qeverisë shqiptare që përfshin politika të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara e që do të hidhen për zbatim gjatë 5 vjeçarit të ardhshëm. Qëllimi i tij është të vazhdojë promovimin dhe mbështetjen e integritit të personave me aftësi të kufizuara në jetën social-ekonomike të vendit duke patur në vëmendje të vazhdueshme përmbushjen e detyrimeve të KDKPAK përmes masave specifike.*

*Procesi i hartimit të këtij dokumenti përputhet edhe me një moment tjetër të rëndësishëm të zbatimit të politikave për aftësinë e kufizuar në Shqipëri në funksion të realizimit të parimeve të KDKPAK, të ratifikuar nga shteti shqiptar.*

*Qëllimi, objektivat specifike dhe masat e parashikuara në këtë plan për realizimin e aksesueshmërisë, adresojnë reduktimin e barrierave për personat me aftësi të kufizuara, me qëllim: (i) sigurimin e aksesit në të mirat materiale, shërbimet dhe lehtësirat; (ii) sigurimin dhe mbajtjen e vendit të punës; (iii) përfshirjen dhe pjesëmarrjen në komunitet; (iv) ndryshimet në sjelljet, qëndrimet dhe veprimet, të cilat diskriminojnë personat me aftësi të kufizuara.*

*Politika orienton institucionet publike në masat që ato duhet të marrin për realizimin e aksesueshmërisë për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara në: (i) mjedise; (ii) transport; (iii) informacion e komunikim”.*

Ky dokument thekson faktin se, qeveria është e angazhuar të administrojë në mënyrë aktive çështjen e aftësisë së kufizuar në Shqipëri duke përditësuar gjithmonë e më shumë të drejtat e PAK në politikat e saj sektoriale. Për arritjen e këtij qëllimi është e nevojshëm edhe mbështetja më e fuqishme kundrejt OJF që veprojnë për mbrojtjen, zhvillimin e promovimin e personave me aftësi të kufizuara në Shqipëri.

Referuar parashikimeve specifike në legjisllacionin ndërkombëtar të ratifikuar nga Shqipëria, legjisllacionin e brendshëm, si dhe standardet ndërkombëtare dhe kombëtare; barazia dhe mosdiskriminimi i personave me aftësi të kufizuara, duhet kuptuar jo vetëm midis personave me

---

<sup>22</sup> Draft final



aftësi të kufizuara dhe personave të tjerë, por dhe midis llojeve e kategorive të ndryshme të aftësisë së kufizuar.

Bazuar në aktet e administruara dhe konstatimet e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, në pamje të parë, pra *prima facie*, faktet dhe provat e administruara krijojnë prezumimin se personat me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, mund të jenë trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pafavorshme, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, megjithëse posedojnë shkakun e mbrojtur nga ligji, atë të aftësisë së kufizuar dhe Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, ishin në dijeni të plotë të këtij fakti.

Në këto kushte Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, kishin barrën e provës që të provonin, që megjithëse trajtimi i pafavorshëm është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Mosdiskriminimi është një e drejtë kushtetuese, e detyrueshme për t'u zbatuar drejtpërsëdrejti nga institucionet. Kjo e drejtë është sanksionuar dhe mbrohet edhe me ligjin nr. 10221 datë 04.02.2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar.

Për të qenë përpara një veprimi diskriminues në kuptim të këtij ligji, Komisioneri vlerëson se, duhet të plotësohen tre kushte njëherësh:

- Të ekzistojë trajtimi i diferencuar i personave me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, në raport me të tjerët në kushte, rrethana të njëjta apo të ngjashme;
- Trajtimi i diferencuar të ketë ndodhur për një nga shkaqet e parashikuara në nenin 1, të këtij ligji;
- Trajtimi i diferencuar të ketë sjellë si pasojë vështirësinë apo pamundësinë e personave me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, për të ushtruar të drejtat dhe liritë e njohura nga kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara apo ligjet e tjera në fuqi.

Në përfundim të analizimit të çështjes në tërësi, Komisioneri vlerëson se, në rastin e personave me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, përmbushen të tre këto kushte njëherësh dhe se, trajtimi i padrejtë dhe i disfavorshëm i tyre, nuk ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

**Në konkluzion të sa më sipër, Komisioneri konstaton se Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tyre, kanë diskriminuar kategorinë e personave me aftësi të kufizuara, të verbër të Bashkisë Korçë, përfaqësuar nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, në të drejtën e tyre për të gëzuar të mirat dhe shërbimet, përsa i takon të drejtës për përzgjedhjen e institucionit (shërbimin postar apo bankar) ku ata do të marrin shërbimin dhe marrjen e tij pa tarifa apo komisione.**

Për rrjedhojë Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, ka shkelur dispozitat e ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, respektivisht: nenin 3, pikat 1 dhe 6, dhe nenin 20, pika 1, shkronja a), dhe nenin 4, të tij.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”.

Në nenin 33, pika 12, të LMD-së, përcaktohet se: “Kur vendos masën, Komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese të shkaktuar, duhet të jetë rivendosja në vend e të drejtës së shkelur të subjektit ankues nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, dhe kjo mund të realizohet nëpërmjet rishikimit të akt-marrëveshjes së nënshkruar dhe parashikimin në të, për marrjen e shërbimeve pa pagesë të personave me aftësi të kufizuara, të verbër dhe pranë institucionit që ata dakordësojnë, sipas akteve ligjore në fuqi.

#### **PËR KËTO ARSYE :**

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

#### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, të verbër, të Bashkisë Korçë, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Filialit të Postës sh.a. Korçë, për shkak të aftësisë së kufizuar.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, të marrin masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ndaj kategorisë së personave të verbër të Bashkisë Korçë, duke i dhënë atyre mundësinë të zgjedhin vetë subjektin për tërheqjen e pagesave, si dhe të zbatojnë legjislacionin duke i përjashtuar nga pagesa e tarifave/komisioneve për shërbimet që ata marrin<sup>23</sup>.
3. Në referim të pikës 1, Bashkia Korçë, të marrë masa për ndreqjen e pasojave dhe rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ndaj kategorisë së personave të verbër të Bashkisë Korçë, duke i kthyer atyre të gjitha shumat e mbajtura që nga momenti (periudha) kur ka nisur aplikimi i tarifave/komisioneve në shërbimet e marra përmes shërbimit postar dhe atij bankar.

<sup>23</sup> Pagesë paaftësie, pagesë verbërie, ndihmë ekonomike etj.

4. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Korçë dhe Filiali i Postës sh.a. Korçë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
5. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)  
(Fusha: Të mira dhe shërbime)